



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 4.9.2023

Nr: 745

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË “PARTISË DEMOKRATIKE”, PËR REGJISTRIMIN
SI SUBJEKT ZGJEDHOR NË ZGJEDHJET E PJESSHME PËR KRYETAR TË BASHKISË KUKËS
TË DATËS 24 SHTATOR 2023

Sot më datë 4.9.2023, në seancë publike mora në shqyrtim kërkesat me nr. 6712 Prot., datë 1.9.2023 dhe nr. 6711 Prot., datë 1.9.2023 me:

Kërkues: Partia Demokratike

Objekti: Regjistrimi i “Partisë Demokratike” si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës të datës 24 Shtator 2023.

Baza ligjore: Neni 64 i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës, si dhe dëgjova pretendimet e palëve pjesëmarrëse në seancën publike,

V Ë R E J:

Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 186, datë 11.8.2023, ka caktuar datën 24 Shtator 2023 si datën e zhvillimit të zgjedhjeve të pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës.

Z. Lulzim Basha, nëpërmjet z. Indrit Sefa, si i autorizuar prej të parit, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën me nr. 6712 Prot., datë 1.9.2023, sipas së cilës kërkohet regjistrimi i “Partisë Demokratike” si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës të datës 24 Shtator 2023.

Z. Sali Berisha ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën me nr. 6711, datë 1.9.2023, për regjistrimin e “Partisë Demokratike” si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës të datës 24 Shtator 2023.

Duke qenë se të dyja kërkesat kanë të njëjtin objekt, u vendos shqyrtimi i tyre së bashku.

Z. Lulzim Basha, së bashku me kërkesën për regjistrimin e Partisë Demokratike si subjekt zgjedhor, ka paraqitur në KQZ edhe dokumentacionin vijues:

- 1) Vërtetimi i lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 29.8.2023;
- 2) Deklarata e angazhimit solemn e nënshkruar nga z. Lulzim Basha (Model KQZ-04-02);
- 3) Deklarata për hapjen e llogarisë së posaçme bankare të partisë politike (Model KQZ-04-03).

Nga dokumentacioni i mësipërm, si dhe nga përmbajtja e kërkesës rezulton se:

- a) Emri zyrtar i partisë është “Partia Demokratike”, me shkronja nistore “PD” ose “PDSH”, me adresë: Bulevardi “Zhan D’Ark”, nr. 11, Tiranë;
- b) Kryetari i partisë është z. Lulzim Basha, me adresë: Bulevardi “Zhan D’Ark”, nr. 11, Tiranë;
- c) Financieri i partisë është z. Ilir Dervishi, me adresë: Rruga e Kavajës, Kompleksi “Square 21”, hyrja 2, kati 4, ap.11, Tiranë;
- ç) Personi përgjegjës për komunikim me KQZ-në është z. Indrit Sefa, me adresë: Rruga e Kavajës Kompleksi “Square 21”, hyrja 2, kati 4, ap.11, Tiranë;
- d) Specimeni i vulës së partisë është i specifikuar.

Kërkuesi z. Sali Berisha, në shoqërim të kërkesës së tij për regjistrimin e “Partisë Demokratike”, ka paraqitur dokumentacionin vijues:

- 1) Deklarata e angazhimit solemn (Model KQZ-04-02);
- 2) Vendimi me nr. 1346/222 Akti, datë 25.3.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Nga përmbajtja e kërkesës rezulton se:

- a) Emri i partisë është “Partia Demokratike” me shkronja nistore “PD” ose “PDSH” me adresë Bulevardi “Zhan Dark”, Tiranë;
- b) Kryetari i partisë është z. Sali Berisha, me adresë: Bulevardi “Zhan Dark”, Tiranë;
- c) Financieri i partisë është z. Arben Ibroja, me adresë: Bulevardi “Zhan Dark” Tiranë;
- ç) Personi përgjegjës për komunikim me KQZ-në është z. Franci Nuri ose z. Ledio Nuraj, me adresë: Bulevardi “Zhan Dark”, Tiranë;

Kërkesa e një partie politike për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor duhet të jetë në përputhje me përcaktimet e nenit 64 të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.

Në vlerësim të të dyja kërkesave për regjistrim të "Partisë Demokratike" (PDSH) si subjekt zgjedhor, të paraqitura respektivisht nga z. Sali Berisha dhe z. Lulzim Basha, çmohet se kërkesa e këtij të fundit është në përputhje me të gjitha përcaktimet e nenit 64 të Kodit Zgjedhor. Nga përmbajtja e vërtetimit të lëshuar nga Zyra e Regjistrimit të Partive Politike pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë datë 29.08.2023, i paraqitur nga z. Indrit Sefa në cilësinë e përfaqësuesit të z. Lulzim Basha, rezulton se ky i fundit është kryetar i PDSH-së.

Në nenin 9 të ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000 "Për partitë politike", i ndryshuar (Ligji për partitë) përcaktohet:

"Regjistrimi i partive politike bëhet në gjykatën e shkallës së parë të rrethit të Tiranës, e cila mban regjistrin e partive politike. Në regjistrin e partive politike shënohet numri rendor i regjistrimit, numri i aktit, numri i vendimit gjyqësor, data e shpalljes, dispozitivi i vendimit, emri i plotë i partisë, inicialet e partisë, stema e partisë, përshkrimi i konfiguracionit të vulës, emri i kryetarit, numri i anëtarëve themelues shënime për ndryshimin e emrit, konfiguracione të vulës ose të kryetarit të partisë, fshirjes apo mbarimit të veprimtarisë së subjektit, data e bërjes së shënimit, emri, si dhe nënshkrimi i nëpunësit kompetent".

Nga përmbajtja e kësaj dispozite del qartë që organi kompetent zyrtar, i cili mundet të lëshojë një dokument të tillë në lidhje me atë se kush është kryetar i një partie politike është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në këto rrethana vërtetimi i kësaj gjykate i datës 29.8.2023, i paraqitur nga z. Indrit Sefa në cilësinë e përfaqësuesit të z. Lulzim Basha, është dokumenti zyrtar sipas ligjit, i cili vërteton se z. Lulzim Basha është kryetar i PDSH-së. Si i tillë, ai ka legjitimitet të plotë për të paraqitur kërkesën në emër të PDSH-së për regjistrimin e kësaj të fundit si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e pjesshme për kryetar të Bashkisë Kukës të datës 24 Shtator 2023.

Z. Franc Nuri, në cilësinë e përfaqësuesit të z. Sali Berisha, pretendoi se vërtetimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë i datës 29.8.2023, i paraqitur nga z. Indrit Sefa, i referohet zgjedhjes së z. Lulzim Basha si kryetar të PDSH në vitin 2013. Sipas tij, z. Basha ka dhënë dorëheqjen nga kryetar i PDSH në vitin 2021 dhe ky është një fakt i njohur botërisht. Është fakt i njohur botërisht vijon z. Nuri pretendimet e tij se z. Sali Berisha është kryetar i PDSH-së, i zgjedhur si i tillë nëpërmjet rregullave të përcaktuara në statutin e PDSH-së.

Pretendimet z. Nuri nuk gjejnë mbështetje në prova dokumentare sikurse kërkohet për këtë rast në përmbushje të përcaktimeve të nenit 9 të ligjit për partitë dhe nenit 64 të Kodit Zgjedhor.

Sikurse më sipër është cituar, vërtetimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë i datës 29.8.2023, i paraqitur nga z. Indrit Sefa vërteton se kryetar i PDSH-së është z. Lulzim Basha.

KQZ-ja nuk ka kompetencën për të hetuar dhe/ose shqyrtuar legjitimitetin e z. Lulzim Basha si kryetar i PDSH-së. Për KQZ-në, përmbajtja e vërtetimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në lidhje me atë

se kush është kryetar i një partie politike është fakt juridik, të cilin KQZ-ja për asnjë rrethanë dhe shkak ligjor nuk mundet ta vendosë në diskutim.

Z. Lulzim Basha, si i legjitimuar për të paraqitur kërkesën për regjistrimin e PDSH-së si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës të datës 24 Shtator 2023, së bashku me kërkesën ka paraqitur edhe dokumentacionin përkatës shoqërues me këtë rast.

Rezulton se ky dokumentacion përfshin edhe deklaratën solemne dhe është në përputhje me pikën 2, shkronjat “c”, “ç”, “d”, “dh” dhe “e” të nenit 64 të Kodit Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, nenin 64, pika 2, dhe nenin 92/2, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe udhëzimit nr. 1, datë 18.1.2023, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin dhe verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”, dhe vendimit të Komisionit Rregullator nr. 28, datë 16.8.2023 “Për miratimin e disa afateve procedurale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për kryetar në Bashkinë Kukës, që do të zhvillohen në datën 24 shtator 2023”,

VENDOS:

1. Regjistrimin e partisë politike “Partia Demokratike”, me kryetar z. Lulzim Basha, me shkronjat nistore “PDSH”, si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës të datës 24 Shtator 2023.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI